



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Priljeño/Prodato Received/Delivery	21.11.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPIYSHICK	7264/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.879/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.879/2022 të datës 07.10.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson [redacted] nga kundër Vendimit me numër protokolli 21KH/2 të datës 16.09.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 21.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet ankesa A.nr.879/2022 e datës 07.10.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted] si e pa bazuar.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 21KH/2 i datës 16.09.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] më datë 07.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5963/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 21KH/2 të datës 16.09.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.01.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje



në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa, Këshilli më datë 14.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat ndërlidhur me çështjen në shqyrtim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën më numër protokolli 5963/2022 të datës 07.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 21KH/2 të datës 16.09.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Ankesën e datës 30.08.2022 të parashtruar nga ankuesi në Zyrën për Ankesa dhe Parashtrësia pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës; Autorizimin e datës 14.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 6080/2022 të datës 11.10.2022; Përgjigjen në ankesë për ankesë me numër protokolli 6230/2022 të datës 14.10.2022; Kërkesën për punësim me numër reference MD/SHKK/017/01.06.2022 të datës 14.07.2022 të me dokumentet si: Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar e datës 28.07.2019, Diplomën e datës 09.09.2003, Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2021 i datës 21.01.2022, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren e datës 04.07.2022; Vërtetimin e datës 13.07.2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës; Vërtetimin e datës 08.07.2022 të lëshuar nga Qendra e Paraburgimit në Prizren, Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2020, Dokumenti identifikimi, Certifikatën e datës 26.07.2008, Certifikatë trajnimi për periudhën 18-22.04.2021, Certifikatën e trajnimit e datës 10.12.2021, Certifikatën e trajnimit për periudhën 14-18.03.2022; Kërkesën për punësim me numër reference MD/SHKK/008/01.06.2022 të datës 14.07.2022 për me dokumentet si: Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar të datës 25.07.2019, Diplomën me numër 4790/0622 të datës 24.06.2022 nga Kolegji Fama; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren me numër 7322/2022 të datës 01.07.2022; Vërtetimin e Policisë së Kosovës të datës 01.07.2022, Vërtetimin të datës 07.07.2022, Formular për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 28.12.2020, Formular për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 21.01.2022; Dokument Identifikimi i Certifikatën trajnimi për periudhën 06.08.2007 deri 16.11.2007 për K.Leku, Certifikatën e lëshuar nga UNMIKU të datës 05.09.2008 për Certifikatë trajnimi e datës 05.09.2008 për Certifikatën për periudhën 22-26.11.2021 për e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Certifikatën të datës 16-20.05.2022 e lëshuar nga Qeveria; Certifikatë trajnimit e datës 22.04.2022 për Diplomën e datës 19.04.2002 për Diplomën e datës 08.08.2002 për Diplomën e datës 02.01.2003 për Certifikatën e lëshuar në muajin korrik 2004 për Certifikatën të datës 28.06.2004 për Certifikatën të datës 30.06.2003 për Diplomën me numër 1087 të datës 11.05.2009 për Certifikatë trajnimi e datës 20-24.06.2014 për Kërkesën për punësim me numër Reference MD/SHKK/008/01.06.2022 të datës 14.07.2022 nga ankuesi me dokumentet si: Kontratë Pune për kohë të Pacaktuar të datës 02.07.2018, Diplomë me numër 679 të datës 25.04.2016 e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina", Vërtetimin e datës 04.07.2022 të Policisë së Kosovës, Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren me numër 7386/2022 të datës 04.07.2022, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 29.12.2020, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 20.01.2022, Dokument Identifikimi për ankuesin; Vërtetimin e datës 07.07.2022 për ankuesin, Certifikatën e datës 16.09-18.10.2019 për ankuesin e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Certifikatë trajnime nëntor 2004 për ankuesin e lëshuar nga Swiss Project, Certifikatë të datës 09.11.2001 për ankuesin e lëshuar nga UNMIKU, Certifikatën të datës 12-16.10.2009 për ankuesin e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Certifikatën të datës 27.06-05.07.2013 për ankuesin; Certifikatë trajnimi për periudhën 15-19.03.2010 për ankuesin e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Certifikatën të datës 08.02.2005-18.03.2005 për ankuesin e lëshuar nga Qendra

e Paraburgimit ne Prizren, Certifikatë e datës 17.01.2005 për ankuesin e lëshuar nga UNMIKU, Certifikatë e datës 22.03.2005 për ankuesin e lëshuar nga Qendra e Paraburgimit ne Prizren, Certifikatë për e lëshuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, Certifikatë trajnimi për periudhën 17.08-21.08.2009 për ankuesin, Certifikatë trajnimi për datat 18, 19, 20.02.2015 për ankuesin, Kërkesën për Punësim me numër Reference MD/SHKK/008/01.06.2022 të datës 14.07.2022 e kandidati me dokumentet si: Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar te datës 04.07.2018, Diplomë me numër D-22/2014 të datës 10.09.2014 për e lëshuar nga Kolegji Evropian "JURIDIKA", Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren me numër 7406/2022 të datës 04.07.2022, Vërtetimin të datës 04.07.2022 për e lëshuar nga Policia e Kosovës, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.01.2022 për Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 2020 për Dokument Identifikimi i Vërtetimin të datës 07.07.2022 për Certifikatën për trajnim të datës 17.06.2022 për Certifikatën të datës 28.04.2000 për Certifikatën të datës 10.12.2021 për Certifikatë trajnimi për periudhën 06-10.07.2015 për Certifikatë për periudhën 16.05-17.06.2022 për Certifikatë të datës 27-29.01.2015 për Formularin për rezultatet përfundimtare e kandidatëve për pozitën mbikëqyrës i lartë i datës 01.09.2022; Formularin e rezultateve të intervistës me gojë për mbikëqyrës i lartë i datës 31.08.2022; Formularin e rezultateve të vlerësimit të intervistës me gojë për mbikëqyrës të lartë pa datë; Ftesa për intervistë me gojë për kandidatet që kanë kaluar testin për mbikëqyrës të lartë; Njoftimin e datës 23.08.2022; Formularin për Rezultatet e vlerësimit të testit me shkrim lista e kandidateve që kanë kaluar testin me shkrim për pozitën Mbikëqyrës i Lartë të datës 19.08.2022; Formularin për Rezultatet e vlerësimit të vlerësimit të testit me shkrim lista e kandidatëve që nuk kanë kaluar testin me shkrim për pozitën Mbikëqyrës i Lartë të datës 19.08.2022; Lista e zyrtarëve që i kanë plotësuar kriteret për testin me shkrim për pozitën Mbikëqyrës i Lartë; Testi me shkrim i ankuesit i datës 18.08.2022; Konkurs i Brendshëm me numër protokollit 629 i datës 02.06.2022 për pozitën Mbikëqyrës i Lartë; Vendimin me numër protokollit 774 të datës 12.07.2022 për formimin e Komisionit Përzgjedhës për procesin e gradimit për Mbikëqyrës i Lartë dhe Mbikëqyrës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstatoi së ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 02.06.2022 ka shpall Konkurs për gradim me numër protokollit 629 për pozitën Mbikëqyrës i Lartë për: Burgun e Sigurisë së Lartë, referenca MD/SHKK/002/01.06.2022, katër (4) pozita; Qendrën Korrektuese në Dubravë, referenca MD/SHKK/003/01.06.2022, katër (4) pozita; Qendrën Korrektuese në Lipjan, referenca MD/SHKK/004/01.06.2022, një (1) pozitë; Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë, referenca MD/SHKK/005/01.06.2022, një (1) pozitë; Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, referenca MD/SHKK/006/01.06.2022, tre (3) pozita; Qendrën e Paraburgimit në Pejë, referenca MD/SHKK/007/01.06.2022, një (1) pozitë; Qendrën e Paraburgimit në Prizren, referenca MD/SHKK/008/01.06.2022, dy (2) pozita; Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, referenca MD/SHKK/009/01.06.2022, një (1) pozitë; Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, referenca MD/SHKK/010/01.06.2022, dy (2) pozita; dhe Qendrën e Paraburgimit për Femra në Lipjan, referenca MD/SHKK/011/01.06.2022, një (1) pozitë.

Me tej, nga shqyrtimi i provave të lëndës është konstatuar së ankuesi me datë 14.06.2022 ka aplikuar për gradën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, me referencë MD/SHKK/008/01.06.2022, ndërsa i njëjti ishte përfshirë në listën e kandidatëve që kanë plotësuar kriteret për t'ju nënshtruar testit me shkrim të mbajtur më datë 18.08.2022, mirëpo që ankuesi sipas listës së datës 19.08.2022 të Komisionit të Pranimit nuk kishte kaluar testin me shkrim përkatësisht ankuesi kishte arritur vetëm 51 nga 60 pikët që kërkohen sipas nenit 15 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimin e së Kaluarës së Tyre, Periudhën Provuese dhe Promovimin.

Ankuesi më datë 30.08.2022 ka parashtruar ankesë në Zyrën për Ankesa dhe Parashtrës të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me kërkesën që të rishqyrtohet dhe rivlerësohet konkursi për gradim i datës 02.06.2022 pasi që janë përzgjedhur zyrtarë me shkelje disiplinore dhe vepra penale. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës më Vendimin më numër protokollit 21KH/2 të datë 16.09.2022 ka refuzuar si të paraafatshme ankesën e ankuesit të datës 30.08.2022, ndërsa ankuesi kundër këtij vendimi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke shtuar së kandidatet e përzgjedhur për pozitën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren janë me shkelje disiplinore dhe më të kaluar kriminale.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore j'u referua nenit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *1.Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë...*" dhe si rrjedhojë konstatoi së nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë si dhe ligjeve të veçanta lidhur me elementet e marrëdhënies së punës që kanë të bëjnë me: *1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve.*

Sipas Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimin e së Kaluarës së Tyre, Periudhën Provuese dhe Promovimin, përkatësisht sipas nenin 19 paragrafi 1 përcaktohet se: *"1. Kandidati që konsideron se i është shkelur ndonjë e drejtë gjatë procesit të rekrutimit dhe seleksionimit ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit të rezultateve përfundimtare në komisionin për ankesa në Shërbimin Korrektues të Kosovës".* Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe në mbështetje të provave të administruara të lëndës, Kolegji ka konstatuar së ankuesi ka parashtruar ankesë të brendshme ende pa u shpallur rezultatet përfundimtare të procesit të rekrutimit për Mbikëqyrës të Lartë sipas Konkursit me numër protokollit 629 të datës 02.06.2022, përkatësisht ankuesi parashtron ankesë më datë 30.08.2022 ndërsa publikimi i rezultateve përfundimtare lidhur me konkursin në fjalë është bërë më datë 01.09.2022. Rrjedhimisht, mbi këtë bazë Kolegji konstaton së me aktin e kontestuar është vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë është zbatuar ligji material gjegjësisht Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka vepruar në pajtim më nenin 125 paragrafi 1 dhe nenin 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si më sipër dhe meqenëse ankesa e ankuesit e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës është konstatuar si e papranueshme, Kolegji me rastin e vendosjes lidhur me këtë çështje juridiko-administrativo nuk ka trajtuar pretendimet ankimore lidhur me ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit sipas Konkursit me numër protokollit 629 të datës 02.06.2022.

Andaj, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin t 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.879/2022

Avdyll BEKTESHI

Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Attachne
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësues më autorizim të ankuesit avokates
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.